




**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

**FOL**

# **RAPORTI MBI KONTRATAT PUBLIKE TË BIZNESEVE TË REJA GJATË VITIT 2019 DHE 2020**

**KORRIK 2021**



---

Titulli: Raporti mbi kontratat publike të bizneseve të reja gjatë vitit 2019 dhe 2020

Autore: Yllka Buzhala

Kontribuoi: Albana Hasani

Viti i botimit: Korrik 2021

Publikuar nga:

Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtina 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+383 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2021. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky publikim është përgatitur nga Lëvizja FOL dhe përkrahur nga USAID përmes aktivitetit të Komunave Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

# PËRMBAJTJA

Hyrje .....	5
Metodologjia .....	5
Përmbledhja ekzekutive .....	6
Korniza ligjore .....	7
Biznese të reja dhe bizneset e rithemeluara.....	10
Kontratat e nënshkruara nga binzeset e reja në vitin 2019 .....	12
Llojet e kontratave publike të nënshkruara .....	13
Vlera mesatare e kontratave krahasuar me bizneset jo të reja.....	16
Kriteret e kërkuara në kontratat dhënë bizneseve të reja .....	18
Procedura e aplikuar në kontratat dhënë bizneseve të reja.....	19
Kontratat e nënshkruara nga bizneset e reja gjatë vitit 2020.....	20
Llojet e kontratave publike të nënshkruara .....	20
Vlera mesatare e kontratave krahasuar me bizneset jo të reja.....	25
Kriteret e kërkuara për lidhjen e këtyre kontratave .....	27
Procedurat e aplikuara në lidhjen e këtyre kontratave .....	28
Vendimet për ankesa për kontratat e nënshkruara në vitin 2020 .....	29
Rekomandimet .....	31
Burimet .....	32

# HYRJE

Lëvizja FOL me mbështetjen e USAID-it në Kosovë, përmes Programit për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM) ka dizajnuar dhe ka ndërtuar Portalin e Prokurimit të Hapur dhe Transparent, si platformë e kontratave të hapura të prokurimit, duke u bazuar në modelin e Transparency International në Sllovaki. Ky portal lexon të dhënat aktuale që publikohen nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, më specifikisht njoftimet për dhënie të kontratave.

Që nga lansimi, portali Portali gjeneron të dhëna për më shumë se 15,700 kontrata të nënshkruara, që nga viti 2018. Ky Portal si një platformë paralele e e-Prokurimit ka rezultuar në një kthesë të madhe në kërkimin e transparencës dhe në hapjen e prokurimit publik, proces i cili deri në vitet e fundit ka qenë i panjohur për qytetarët. Po ashtu, ndërthurja e të dhënave për bizneset në këtë Portal, që marrin kontrata publike është mundësuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, në lidhje me numrat identifikues të bizneseve dhe pronarët e tyre. Në këtë drejtim, është parë e rëndësishme që të paraqitet një pasqyrë për bizneset e reja, që marrin kontrata publike, ku marrja e të dhënave, ndër të tjera, është bërë bashkë-dyuar prokurimin e Hapur dhe faqen zyrtare të ARBK-së.

Korniza ligjore që mbulon fushën e prokurimit publik parasheh trajtim të barabartë për të gjitha bizneset gjatë aktivitetit të prokurimit. Ndërkaq, çdo vit themelohen diku rreth 10 mijë biznese të reja, që eventualisht hyjnë në aktivitete të prokurimit publik. Në këtë linjë, Lëvizja FOL, përmes monitorimit të aktiviteteve të prokurimit në platformën "Prokurimi i Hapur", në këtë raport ka paraqitur një pasqyrë të bizneseve të reja të hapura në 2019 dhe 2020 dhe përfshirjes së tyre në aktivitete të prokurimit.

Ky raport paraqet nivelin e përfshirjes së këtyre bizneseve përmes llojeve të kontratave, si dhe të dhëna në lidhje me kriteret që janë kërkuar në dosjet e tenderit të cilat këto lloj biznesesh kanë qenë përfituese, shumën e vlerave të kontratave të fituara në raport me bizneset jo të reja, si dhe një varg informatash tjera relevante.

## METODOLOGJIA

Lëvizja FOL me mbështetjen e USAID-it në Kosovë, përmes Programit për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM) ka dizajnuar dhe ka ndërtuar Portalin e Prokurimit të Hapur dhe Transparent, si platformë e kontratave të hapura të prokurimit, duke u bazuar në modelin e Transparency International në Sllovaki. Ky portal lexon të dhënat aktuale që publikohen nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, më specifikisht njoftimet për dhënie të kontratave.

Që nga lansimi, portali Portali gjeneron të dhëna për më shumë se 15,700 kontrata të nënshkruara, që nga viti 2018. Ky Portal si një platformë paralele e e-Prokurimit ka rezultuar në një kthesë të madhe në kërkimin e transparencës dhe në hapjen e prokurimit publik, proces i cili deri në vitet e fundit ka qenë i panjohur për qytetarët. Po ashtu, ndërthurja e të dhënave për bizneset në këtë Portal, që marrin kontrata publike është mundësuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, në lidhje me numrat identifikues të bizneseve dhe pronarët e tyre. Në këtë drejtim, është parë e rëndësishme që të paraqitet një pasqyrë për bizneset e reja, që marrin kontrata publike, ku marrja e të dhënave, ndër të tjera, është bërë bashkë-dyuar prokurimin e Hapur dhe faqen zyrtare të ARBK-së.

Fillimisht në këtë raport është përmbledhur korniza ligjore në të cilën bazohet krijimi i bizneseve të reja dhe nënshkrimi i kontratave publike, si dhe llojet dhe procedurat e lidhjes së këtyre kontratave.

Ndërkaq në pjesën e tjetër të raportit, me qëllim të krijimit të një pasqyre sa më të përgjithshme të kontratave publike të nënshkruara nga bizneset e reja, është krijuar një përmbledhje e numrit të kontratave të lidhura nga bizneset e reja gjatë vitit 2019 dhe 2020, respektivisht janë paraqitur të dhëna specifike në lidhje me numrin e bizneseve të reja të regjistruara gjatë këtyre viteve, të dhënat në lidhje me numrin dhe vlerën e kontratave të nënshkruara, kriteret e kërkuara për lidhjen e këtyre kontratave, të dhënat në lidhje me procedurat e prokurimit që janë zbatuar gjatë lidhjes së këtyre kontratave, si dhe të dhënat në lidhje me numrin e vendimeve të ankesave nga OSHP ndaj palëve ankuese.

Duhet të potencohet se analiza e të dhënave në raport është e ndarë për kontratat e lidhura gjatë vitit 2019 dhe 2020. Për vitin 2019 janë marrë për bazë bizneset e themeluara gjatë këtij viti, ndërsa për vitin 2020 janë marrë për bazë bizneset e themeluara gjatë vitit 2019 dhe gjatë vitit 2020. Ndërkaq bizneset e shuara dhe të rithemeluara në të njëjtën periudhë kohore nuk janë fokus i analizës sonë (më gjerësisht në lidhje me bizneset e rithemeluara, shih kapitullin "Bizneset e Reja dhe Bizneset e Rithemeluara").

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në bazë të të dhënave që Lëvizja FOL ka siguruar, mbi 70 biznese të themeluara gjatë viteve 2019 dh 2020 kishin nënshkruar kontrata publike të prokurimit gjatë këtyre dy viteve. Është mjaft e rëndësishme që këto biznese kanë fokus pjesëmarrjen në aktivitet të prokurimit, duke rritur kështu edhe konkurrencën në treg, por edhe cilësinë. Ndërkaq janë një varg kriteresh që autoritetet kontraktuese i paraqesin në dosje të tenderit në këto aktivitete të prokurimit, e që të dyja palët duhet t'i përmbahen, sikurse autoritetet kontraktuese, ashtu edhe bizneset që hyjnë në këto aktivitete. Përvoja dhe profesionalizmi është njëra nga kriteret që kërkohet në dosje të tenderit, e sidomos për aktivitete e prokurimit të llojit punë. Pavarësisht, që numri i bizneseve të reja që kanë marr kontrata është shumë i vogël, në raport me ato jo të reja, mund të theksojmë se kontratat e llojit punë nuk do të duhej t'i jepeshin bizneseve të reja. Apo në raste të caktuara kriteret do të duhej t'i përshtateshin natyrës së kontratave që pretendohet të lidhen, ku na raste të caktuara kriteret për përvojë së paku tre vjeçare, kanë qenë të panevojshme. Për më shumë, në vijim do të përshtatim disa nga gjetjet kryesore të këtij raporti.

- Prej rreth 19 mijë bizneseve të themeluara gjatë viteve 2019 dhe 2020, vetëm 72 biznese kishin nënshkruar kontrata publike;
- Këto 72 biznese kishin lidhur gjithsej 249 kontrata publike, 44 prej të cilave ishin kontrata pune, 155 kontrata të furnizimit dhe 50 kontrata të shërbimeve;
- Vlera e përgjithshme e kontratave të punës të lidhura nga bizneset e reja gjatë këtyre dy viteve ishte 1,213,536.27 euro, vlera e kontratave të furnizimeve ishte 1,952,537.11 euro, ndërkaq vlera e kontratave të shërbimeve ishte 365,650.5 euro;
- Ndërkaq, vlera mesatare e kontratave të punës ishte 27,580.40 euro, vlera mesatare e kontratave të furnizimit ishte 12,597.10 euro, si dhe vlera mesatare e kontratave të shërbimeve ishte 7,313 euro. Nga bizneset jo të reja, vlera mesatare e kontratave të punës ishte 152,440.90 euro, vlera mesatare e kontratave të furnizimit ishte 33,780.27 euro, si dhe vlera mesatare e kontratave të shërbimeve ishte 33,788.24 euro;
- Objekti i kontratave të punës të lidhura nga bizneset e reja gjatë kësaj periudhe, ka qenë në lidhje me çështje të ndryshme, duke përfshirë kontratat për ndërtimin dhe riparimin e rrugëve, ndërtimin e hapësirave të gjelbërta, ngritjen e punishteve, ndërtimi i urave, asfaltimin e rrugëve, etj;

- Ndërkaq objekti i kontratave për furnizime të nënshkruara gjatë kësaj periudhe nga bizneset e reja ishte kryesisht për furnizime me dezinfektues për banoret në hyrje të ndërtesave, furnizimi me tunel dezinfektues, dhe maska ditore higjienike, pastaj furnizimi i bibliotekave me inventar, me pajisje për shuarjen e zjarrit, furnizimi me tonerë, kompjuterë, pelet, pajisje sportive, goma, bateri për automjete dhe të ngjashme;
- Edhe objekti i kontratave për shërbime ka qenë në lidhje me çështje të ndryshme, duke filluar nga dezinfektimi i hapësirave të brendshme në institucionet publike, shërbime të autolarjes së veturave zyrtare, mirëmbajtja dhe pastrimi i zonave rurale, mirëmbajtja e kamerave të sigurisë, transporti i nxënësve, trajtimi i qenve endacak, vendosja e roletave në objektin e komunës, dhe të ngjashme;
- Në shumicën prej kontratave publike të lidhura gjatë vitit 2019 dhe 2020, përkatësisht në 156 kontrata, nuk është kërkuar dëshmi mbi gjendjen ekonomike-financiare dhe kapacitetet profesionale, kurse në 85 prej këtyre kontratave është kërkuar dëshmi mbi kriteret të tilla, ndërsa në 7 sosh nuk ka pasur të dhëna. Gjithashtu, në kriteret e kërkuara për kontratat furnizim dhe shërbime ka pasur raste që në disa dosje të tenderit është kërkuar përvoja e kapaciteteve teknike dhe profesionale si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, pavarësisht që rastet e para të të infektuarve me COVID-19 janë paraqitur në mars të vitit 2020 dhe ka qenë e pamundur që bizneset të kenë përvojë për furnizim dhe shërbime në këtë fushë;
- Në 64 kontrata publike të nënshkruara gjatë këtij viti ishte aplikuar procedura e hapur e prokurimit, në 153 kontrata është aplikuar procedura e kuotimit të çmimit, në 33 kontrata është aplikuar procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratë;
- Në kontratat e nënshkruara në vitin 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) kishte marrur katër vendime për ankesat e parashtruara nga palët e pakënaqura. Prej këtyre vendimeve të marrura nga OSHP, në një rast ishte aprovuar pjesërisht ankesa, në një rast është refuzuar në tërësi, në një rast është hudhur si e palejuar, dhe në një rast ishte hudhur si e pas-afatshme;
- Një e gjetur tjetër e rëndësishme është se në ARBK për bizneset e shuara dhe rithemeluara (që kanë ndërruar status) nuk ka lista të veçanta. Gjatë analizimit të të dhënave në vitin 2019 dhe 2020 janë themeluar rreth 19 mijë biznese të reja, prej të cilave 123 biznese kishin lidhur kontrata publike. Prej këtyre, 20 biznese apo 16.3 % e tyre ishin shuar dhe rithemeluar gjatë këtyre dy viteve, ndërsa 72 biznese apo 58.5 % e tyre ishin krijuar si të reja. Ndërkaq për 31 biznese nuk janë gjetur të dhëna nëse janë plotësisht të reja, apo janë rithemeluar, e që në fakt i bie ndërrim statusi, prej një shoqërie tregtare në tjetrën. Po të mos filtroheshin këto të dhëna në portalin Prokurimi i Hapur dhe në web faqen e ARBK-së dhe të merreshin të gjitha këto 123 biznese “të reja” si pjesë e analizës, do të kishim një pasqyrim të gabueshëm të gjetjeve në këtë raport.

## KORNIZA LIGJORE

Çështja e klasifikimit dhe organizimit të shoqërive tregtare përmes të cilave mund të kryhen veprimtaritë ekonomike në Kosovë, si dhe kërkesat, kushtet, procedura e regjistrimit të këtyre shoqërive dhe çështje të tjera, rregullohen me **Ligjin nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare**, i cili ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2018.

Ky ligj ka përcaktuar rregulla edhe për shndërrimin e statusit të shoqërive tregtare në korporata apo shoqëri të tjera. Sipas nenit 257 të këtij ligji, në momentin kur një shndërrim hyn në fuqi, korporata e shndërruar (mbijetuar) vazhdon të jetë subjekti i njëjtë dhe pa ndërprerje sikurse korporata e mëparshme, si dhe është përgjegjëse për të gjitha asetet

Çdhe detyrimet e çfarëdo lloji. Pra sipas këtij neni, të gjitha kontestet dhe pretendimet kundër korporatës së shndërruar mund të vazhdojnë kundër korporatës së re dhe se statuti i korporatës vazhdon të jetë i njëjti me atë të korporatës së shndërruar. Si rezultat, janë nxjerr një varg aktesh nënligjore që rregullojnë procedurat duke ju dhënë mundësi shoqërive tregtare të shndërrohet në shoqëri të tjera. Kjo lë të nënkuptojë që të gjitha ato biznese që kanë hyrë në procedura të prokurimit publik, ju bartet edhe përvoja profesionale edhe pas shndërrimit në shoqëri apo të tjera.

Sipas nenit 19 të këtij ligji, me rastin e regjistrimit fillestar të shoqërisë tregtare, subjektit i lëshohet numri unik identifikues i cili shërben njëkohësisht si numër për identifikimin e shoqërisë tregtare për qëllime të regjistrimit dhe për qëllime tatimore, si dhe për qëllime të tjera të përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria. Ndërkaq sipas nenit 4 të Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Kërkesave, Kushteve dhe Procedurave për Krijimin e Numrit Unik Identifikues, ky numër lëshohet vetëm njëherë për shoqërinë tregtare në momentin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, përjashtimisht në rast se ndryshon statusin juridik.

Ndërkaq, me qëllim të përafrimit me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian dhe përmirësimit të procesit të prokurimit publik në Kosovë, Kuvendi i Republikës së Kosovës në shtator të vitit 2011 kishte sjellë **Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës**, i cili ishte ndryshuar dhe plotësuar edhe tri herë pas miratimit.

Ky ligj ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese (autoriteteve publike dhe kompanive private) në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen. [1]

I përbërë nga 135 nene, ky ligj përmban parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohet prokurimi publik në Kosovë, kërkesat e përgjithshme në lidhje me prokurimin publik, rregullat për vlerësimin dhe klasifikimin e kontratave publike dhe konkurseve të projektimit, rregullat për specifikimin teknik dhe dosjen e tenderit, llojet dhe zbatueshmërinë e procedurave të prokurimit, udhëheqjen e procedurave të prokurimit, mjetet juridike, si dhe çështje të tjera të rëndësishme të procesit të prokurimit.

Në kuptim të këtij ligji, kontrata publike është term i përgjithshëm që përfshin njërin nga llojet e veçanta të kontratave të lidhura nga një autoritet kontraktues (kontratë shërbimi, kontratë e furnizimi, kontratë pune duke përfshirë kontratën e koncesioneve të punës dhe/ose kontratën publike kornizë). [2]

Sipas ligjit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj. KRPP-ja përbëhet prej 3 anëtarëve. Këta anëtarë emërohen për një mandat prej 5 vjetësh, dhe mund të riemërohen vetëm një herë. [3]

Ndërkaq Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është organ i pavarur për shqyrtim administrativ dhe përbëhet nga 5 anëtarë të Bordit. Nëse ndonjë autoritet kontraktues paraqet ndonjë kërkesë për të dhëna të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritet që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në 1 vjeçare. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative. [4]



Në pjesën e dytë të këtij ligji, përkatësisht në nenin 27 të tij, janë përcaktuar rregullat për specifikimet teknike dhe dosjen e tenderit. Sipas këtij neni, autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshme ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe 24 informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues.

Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin. Këto kushte të dosjes së tenderit, nuk zbatohen për aktivitetet e prokurimit për kontratat me vlerë minimale. [5]

Sipas nenit 28 të këtij ligji, autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.

Sa i përket llojit të objektit të kontratës, ligji njeh tri lloje të kontratave:

- **Kontratat e punës** (kontrata me shpërblim në para, të lidhur ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë kontraktuesve të punëve, që ka detyrë kryesore zbatimin, projektimin dhe përbushjen, ose realizimin e punës ose ndërtimit ose aktiviteteve ndërtimore komunale, që do të thotë aktiviteteve që janë drejtpërdrejt të përfshira në ndërtimin, restaurimin, riparimin ose shkatërrimin e godinave, pajisjeve, strukturave ndërtimore, strukturave tjera etj.)
- **Kontratat e furnizimit** (kontrata me shpërblim në para të lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë furnizuesve që ka të bëjë vetëm ose kryesisht me blerjen, qiradhënien, qiradhënien ose blerjen me këste, me ose pa mundësi blerje, të një ose më shumë produkteve
- **Kontratat e shërbimit** (çfarëdo lloj kontrate, duke përjashtuar kontratat e punës apo furnizimit me shpërblim me para, të lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë ofruesve të shërbimeve).

Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Detajet në lidhje me kriteret, dëshmitë dhe kualifikimet tjera që mund të kërkohen në dosjen e tenderit për lloje të ndryshme të kontratave, janë përcaktuar në nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik.. [6]

---

1. [1] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 1.

2. [1] Po aty, neni 4.

3. [1] Po aty, neni 86 dhe 89.


4. [1] Po aty, neni 98 dhe 99.

# BIZNESE TË REJA DHE BIZNESET E RITHEMELUARA

Gjatë vitit 2019 dhe 2020 janë themeluar rreth 19 mijë biznese të reja. Nga 123 biznese që kanë lidhur kontrata publike, 20 biznese apo 16.3 % e tyre ishin shuar dhe rithemeluar gjatë këtyre viteve, ndërsa 72 biznese apo 58.5 % e tyre ishin krijuar si të reja. Ndërsa për 31 biznese nuk janë gjetur të dhëna nëse janë plotësisht të reja, apo janë rithemeluar, e që në fakt i bie ndërrim statusi, prej një shoqërie tregtare në tjetër ashtu siç e kemi interpretuar në bazën ligjore.

Në grafikën e mëposhtme është shprehur në formë të përqindjes numri i bizneseve të reja të krijuara fillimisht në vitin 2019 dhe 2020, dhe numri i bizneseve që gjatë këtyre viteve janë shuar dhe krijuar përsëri.

## PËRQINDJA MES BIZNESEVE TË REJA DHE ATYRE QË JANË SHUAR DHE THEMELUAR NË VITIN 2019 DHE 2020



**Grafikoni 1.**

Të dhëna në lidhje me numrin e bizneseve të reja dhe të atyre që janë rithemeluar në vitin 2019 dhe 2020, të shprehura në përqindje.

5. [1] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 27.

6. [1] Po aty, neni 69.

Duhet të theksohet që pavarësisht që këto biznese ishin themeluar gjatë vitit 2019 dhe 2020, ka prej tyre që në fakt kanë ekzistuar më herët dhe kanë pasur histori në implementim të kontratave, por që janë shuar dhe janë rithemeluar në të njëjtën ditë. Këto biznese janë me të njëjtin emër tregtar dhe me të njëjtin pronarë, por që ARBK nuk ka lista të veçanta, një vetëm për biznese të reja dhe një listë tjetër me ato biznese që janë shuar dhe rithemeluar. Duhet të potencohet se kjo e gjetur u bë e mundshme përmes Portalit Prokurimi i Hapur dhe Transparent, duke kërkuar me emra të ngjashëm apo të përafërt të bizneseve, të cilat më pas u verifikuan edhe në ARBK. Si rezultat, analiza jonë do të përqendrohej në 92 biznese që kanë lidhur rreth 404 kontrata publike. Ndërkaq, pas filtrimit përmes portalit, 72 biznese që kanë lidhur 249 kontrata publike janë fokus i analizës tonë. Për të parë se si kemi ardhur te kjo e gjetur në portal, shihni foton më poshtë për dy biznese, Risamont dhe EBK:



**Figura 1.**

Pasqyrimi i të dhënave për bizneset e shuara dhe rithemeluara në të njëjtën periudhë kohore.



**Figura 2.**

Pasqyrimi i të dhënave për bizneset e shuara dhe rithemeluara në të njëjtën periudhë kohore.

Më pas, gjatë verifikimit në faqen e ARBK-së, del që N.P.“Risamont” është shuar dhe rithemeluar “RISAMONT SH.P.K.” në të njëjtën datë. E njëjta vlenë edhe për biznesin EBK dhe për 13 biznese tjera që janë shuar dhe rithemeluar në të njëjtën kohë.

Duhet të theksohet se korniza ligjore e lejon ndërrimin e statusit të shoqërive tregtare, duke ofruar edhe procedura të qarta. Ndërkaq në lidhje me arsyeshmërinë e ndërrimit të statusit të këtyre bizneseve të rithemeluara nuk ka informata të publikuara në ARBK.

Duhet të theksojmë që pavarësisht që numri i bizneseve të reja që janë fokus i analizës sonë është 72, mund të ketë prej tyre që kanë pasur status tjetër dhe më pas janë shndërruar në shoqëri tjetër tregtare, por që në gjatë hulumtimit tonë në kemi gjetur ndonjë të dhënë që e vërteton këtë. Si rezultat nuk mund ta bartim rrezikun nëse ndonjë biznes i mëparshëm ka ndërruar status, apo emrin tregtar, apo ka përdorur historikun e bizneseve të mëparshme në aktivitetet e prokurimit, pasi që këto nuk kemi mundur t'i identifikojmë përmes burimeve tona të hulumtimit.

---


## KONTRATAT E NËNSHKRUARA NGA BIZNESET E REJA NË VITIN 2019

Në vitin 2019 në Kosovë ishin krijuar gjithsej 10.044 biznese të reja. Prej tyre, vetëm 31 biznese kishin nënshkruar kontrata publike. Ashtu edhe siç është theksuar në metodologjinë e monitorimit, fokus i analizës tonë janë vetëm kontratat publike të nënshkruara me biznese të reja të themeluara gjatë vitit 2019, d.m.th. janë përjashtuar nga analiza biznese e shuara dhe të rithemeluara gjatë këtij viti. Në raport me numrin e bizneseve aktive në Kosovë, e që janë 172,278 [7] , diku 0,018% e bizneseve të reja kanë lidhur kontrata publike. Nga kjo vërehet se është një përqindje relativisht e ulët, por që në fakt mund të jetë e pranueshme, për shkak se jo të gjitha bizneset mund të kenë fokus pjesëmarrjen në aktivitete të prokurimit. Ndërkaq, edhe ato biznese që mund të kenë fokus pjesëmarrjen në aktivitete të prokurimit, duhet t'i plotësojnë disa kriteret, siç është përvoja e punës, kapacitetet, shkathtësitë apo kriteret e tjera që kërkohen në dosjen e tenderit.

Prej 46 bizneseve që kishin nënshkruar kontrata publike në vitin 2019, 15 biznese apo 32.6 % e tyre ishin shuar dhe themeluar në vitin 2019 (disa prej të cilave e kishin ndërruar statusin, e disa kishin vazhduar si të njëjta), ndërsa 31 biznese apo 67% e tyre ishin krijuar si të reja gjatë vitit 2019.

Në grafikën e mëposhtme është shprehur në formë të përqindjes numri i bizneseve të reja të krijuara fillimisht në vitin 2019, dhe numri i bizneseve që gjatë këtij viti janë shuar dhe krijuar përsëri.

## PËRQINDJA E BIZNESEVE TË REJA DHE E ATYRE QË JANE SHUAR DHE THEMELUAR NË VITIN 2019



**Grafikoni 2.**


Të dhëna në lidhje me numrin e bizneseve të reja dhe të atyre që janë rithemeluar në vitin 2019 të shprehura në përqindje.

## LLOJET E KONTRATAVE PUBLIKE TË NËNSHKRUARA

Gjatë vitit 2019, 31 bizneset kishin lidhur gjithsej 53 kontrata publike, 10 prej të cilave ishin kontrata pune, 37 kontrata të furnizimit dhe 6 kontrata të shërbimeve. Ashtu si edhe mund të shihet në grafikun, ka një dallim mjaft të madh në raport me numrin e llojit të kontratave të lidhura nga bizneset jo të reja. Këto të dhëna, janë të pritshme e që qëndrojnë në një linjë me supozimin tonë, që bizneset e reja potencialisht mund të lidhin më pak kontrata në raport me bizneset jo të reja.

Në dy grafikun e mëposhtme janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin dhe vlerën e këtyre kontratave të nënshkruara nga bizneset e reja dhe jo të reja gjatë vitit 2019.

## Lloji i kontratave për vitin 2019




Grafikoni 3.

Numri i llojit të kontratave nga bizneset e reja dhe jo të reja të nënshkruara nga bizneset e reja gjatë vitit 2019

Vlera e kontratave të punës të lidhura gjatë këtij viti nga bizneset e reja ishte 434,682.44 €, vlera e kontratave të furnizimeve ishte 504,460.51 €, ndërkaj vlera e kontratave të shërbimeve ishte 358,492.31€. Pra natyrisht, njëjtë sikurse me llojin e kontratave, ka dallim të madh me vlerën e kontratave të lidhura me bizneset e reja në raport me bizneset jo të reja.

## Vlera e kontratave për vitin 2019 (€)



Grafikoni 4.

Vlera e kontratave nga bizneset e reja dhe jo të reja të nënshkruara nga bizneset e reja gjatë vitit 2019

Ashtu siç është potencuar në kornizën ligjore, prej kritereve që mund të parashihen në dosjen e tenderit janë edhe kërkesat e përshtatshmërisë dhe kualifikimit të operatorit ekonomik. Ndër të tjera, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Detajet në lidhje me kriteret, dëshmitë dhe kualifikimet tjera që mund të kërkojnë në dosjen e tenderit për lloje të ndryshme të kontratave, janë përcaktuar në nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Prej kontratave të punës të nënshkruara në vitin 2019, pjesa më e madhe kanë qenë kontrata të orientuara për ndërtime, kryesisht rindërtime dhe renovime, si dhe asfaltime.

Këtu mund ta marrim rastin e “LUNARI COMPANY SH.P.K.” që ka lidhur kontratë me Komunën e Kaçanikut për asfaltimi i rrugës “Triumf Riza” në Stagovë. Sipas listës të siguruar nga KRPP, kjo kontratë është nënshkruar më 20 gusht të vitit 2019, e që sipas statusit në e-prokurim është ende në përgatitje dhe kontrata si e tillë nuk ka datë të përfundimit. Duhet të theksohet se në dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, është kërkuar përvojë në projekte të realizuara në tri vitet e fundit, llogaritur nga data e publikimit të njoftimit për tender. Kjo kompani ka edhe katër kontrata tjera të llojit “punë” me Komunën e Kaçanikut gjatë vitit 2019. Për të gjitha këto aktivitete të prokurimit në e-prokurim është gjendur vetëm dosja e tenderit, ndërkaq kontratat nuk janë gjendur.



**Figura 3.**

Pasqyrimi LUNARI COMPANY SH.P.K nga butoni i rrjetëzimiti me institucionet që ka lidhur kontrata.

Po ashtu në kuadër të kontratave të llojit punë, Komuna e Ferizajt ka nënshkruar kontratë me “EGZONI R SH.P.K.” për renovimin e varrezave të Dëshmorëve në Ferizaj. Vlera e kësaj kontrate është 5410 euro dhe është nënshkruar më 11.06.2019 Sipas dosjes së tenderit kjo kompani ka pasur ofertën më të lirë, pavarësisht që në kritere është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë një vlerë jo më pak se 6,000.00 € në lidhje me furnizimet të njëjta gjatë tri viteve të fundit, nga data e njoftimit për kontratë. Ndërkaq, “EGZONI R SH.P.K.” është themeluar me 22 shkurt 2019 dhe ka arritur të lidhë kontratë, pavarësisht që në dosje të tenderi është kërkuar përvojë në furnizime të ngjashme në tre vitet e fundit.

Në shumicën e aktiviteteve të prokurimit në kuadër të llojit punë, në dosje të tenderit është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të kenë dëshmi për aktivitete të ngjashme në tre vitet e fundit. Bazuar në dosjet e tenderit për kontratat e lartëcekura, vetëm për "LUNARI COMPANY SH.P.K." nuk kemi informata se në bazë të cilave kritere ka lidhur kontratat, pasi që nuk e kishte të plotë dosjen në e-prokurim, meqë i mungonin njoftimet për operatorin e suksesshëm dhe kontratat. Ndërkaq, bazuar nga Njoftimet mbi vendimin e autoritetit kontraktues për operatorin e suksesshëm, bizneset tjera kishin fituar kontrata bazuar në çmimin më të ulët, apo pasi që konkurentëve tjerë në garë iu kanë munguar dokumente të caktuara që ishin kusht për kualifikim.

Pesë kontratave të lidhura me "LUNARI COMPANY SH.P.K." kanë qenë përmes procedurës së hapur, por për të cilat kontrata nuk kemi informata në bazë të cilave kritere është shpallur fitues ky operatorë ekonomik, pasi që dosja e tenderit në e-prokurim nuk është e plotë. Ndërkaq pesë kontratat tjerë të llojit punë të lidhura me operatore tjerë, kanë qenë përmes procedurës së kuotimit të çmimit - vlerë e ulët.

**Ndërkaq kontratat e shërbimeve** ishin lidhur për çështje të ndryshme, duke filluar nga kontratat ku objekt i saj ishte mirëmbajtja e vulave, zbrazja e rezervarit nga ujërat e zeza në vagonët e transportit të udhëtarëve, përditësim i softuerit, ofrimi i shërbimeve për reklamim në portalet vendore online, pastrimi dhe larja e automjeteve, kalibrimi i valvolave sigurorese, përgatitje të video-spotëve, si dhe shërbime për realizimin e kampanjës mobilizuese për konsultime publike.

**Gjithashtu edhe objekti i kontratave për furnizime** ka qenë në lidhje me furnizimin me materiale të ndryshme, duke filluar nga furnizimi me litar të çelikut, furnizimi me bukë dhe burek, furnizimi me qese najloni, furnizimi me akumulatorë etj.

Pothuajse në të gjitha dosjet e tenderit në kontratat e llojit furnizim dhe shërbime nuk janë kërkuar kritere në lidhje me përvojën profesionale apo dëshmi të tjera të ngjashme ndër vite. Si rezultat, bizneset e reja i bie që kanë qenë të përshtatshme të lidhin kontrata me autoritete publike. Pavarësisht kësaj, përveç kontratave punë, për të rritur konkurrencën në mes të bizneseve do të ishte mirë që të mos ketë kritere kufizuese për bizneset e reja në kuadër të llojit shërbime dhe furnizim, siç mund të jenë vitet e punës, përderisa i plotësojnë kërkesat tjera profesionale.


---

## VLERA MESATARE E KONTRATAVE KRAHASUAR ME BIZNESET JO TË REJA

Sa i përket vlerës mesatare të këtyre kontratave të lidhura nga bizneset e reja gjatë vitit 2019, vlera më e lartë e tyre ishte për Kontratat e punës. Përkatesisht, vlera mesatare e kontratave të punës ishte 56,819.1 euro, vlera mesatare e kontratave të furnizimit ishte 13,634.1 euro, si dhe vlera mesatare e kontratave të shërbimeve 44,686.5 euro.



## Vlera mesatare për llojet e kontratave të lidhura nga bizneset e reja dhe jo te reja (€)



**Grafikoni 4.**

Vlera e kontratave nga bizneset e reja dhe jo të reja të nënshkuara nga bizneset e reja gjatë vitit 2019

Kontratat e punës kishin vlerën më të madhe mesatare edhe nga bizneset jo të reja, të nënshkuara gjatë vitit 2019. Përkatësisht, vlera mesatare e kontratave të punës ishte 200,554.1 euro, vlera mesatare e kontratave të furnizimit ishte 33,977.1 euro, si dhe vlera mesatare e kontratave të shërbimeve 3696.80 euro.

Bazuar në shifrat e paraqitura më lartë, vërehet se mesatarja është shumë më e lartë në kontratat e punës tek bizneset e vjetra në raport me ato të rejtat, që në fakt është një mesatare e pritshme dhe e pranueshme. Ashtu siç është theksuar më lartë për aktivitetet e prokurimit të llojit “punë”, përvoja profesionale dhe ekspertiza ndër vite është një kriter mjaft i rëndësishëm e që duhet të merret parasysh karshi specifikave të paraqitura në dosje të tenderit.


Po ashtu, edhe në kontratat e llojit “furnizim” dhe “shërbime”, vlera mesatare është më e madhe tek bizneset jo të reja në raport me ato të vjetra.

# KRITERET E KËRKUARA NË KONTRATAT DHËNË BIZNESEVE TË REJA

Në shumicën prej kontratave publike të lidhura gjatë këtij viti, përkatësisht në 12 kontrata është kërkuar dëshmi mbi gjendjen ekonomike-financiare dhe kapacitetet profesionale, në 39 prej këtyre kontratave nuk është kërkuar dëshmi mbi kriteret e tilla, ndërsa për 2 sosh nuk kemi gjetur të dhëna në e-prokurim për shkak që ka munguar dosja e tenderit. Në 12 kontrata ku është kërkuar dëshmia mbi gjendjen ekonomike-financiare dhe kapacitetet profesionale, kanë qenë kontrata të llojit “punë”, të cilat janë analizuar në nënkapitullin për llojin e kontratave.

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur të dhëna në lidhje me numrin e kontratave publike të lidhura gjatë vitit 2019 në të cilat është kërkuar dëshmi mbi gjendjen ekonomike-financiare dhe kapacitetet profesionale, të atyre që nuk janë kërkuar kriteret e tilla, si dhe numri i kontratave për të cilat nuk janë gjetur të dhëna.

## Kriteret e kërkuara për lidhjen e kontratave gjatë vitit 2019




**Grafikoni 6.**

Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019 në të cilat kërkohet dëshmi mbi gjendjen ekonomike dhe kapacitetet profesionale, si dhe numri i kontratave ku nuk janë kërkuar kriteret e tilla.

# PROCEDURA E APLIKUAR NË KONTRATAT DHËNË BIZNESEVE TË REJA

Në shumicën prej këtyre kontratave, përkatësisht në 34 prej tyre, është aplikuar procedura e kuotimit të çmimit, në 21 kontrata është aplikuar procedura e hapur e prokurimit, si dhe në 2 kontrata është aplikuar procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës.

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur të dhëna në lidhje me llojet e procedurave të prokurimit në të cilat janë lidhura kontratat gjatë vitit 2019.



**Grafikoni 7.**

Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019 të klasifikuara në bazë të procedurës së zbatuar të prokurimit.

Duhet të theksohet se ndaj kontratave të nënshkruara në vitin 2019 nga bizneset e reja në Organin Shqyrtues të Prokurimit, nuk ka pasur asnjë ankesë të palëve të pakënaqura.

# KONTRATAT E NËNSHKRUARA NGA BIZNESET E REJA GJATË VITIT 2020

Për kontratat publike të nënshkruara në vitin 2020 janë marrë parasysh bizneset e regjistruara në vitin 2019 dhe 2020. Në vitin 2019 ishin krijuar gjithsej 10.044 biznese të reja, kurse në vitin 2020 janë krijuar 9,649 biznese. Prej tyre, 196 biznese kishin nënshkruar kontrata publike gjatë vitit 2020. Fokus i analizës tonë janë vetëm kontratat publike të nënshkruara me biznese të reja të themeluara gjatë këtyre viteve, d.m.th. janë përjashtuar nga analiza bizneset e shuara dhe të rithemeluara në po të njëjtën periudhë kohore. Në raport me numrin e bizneseve aktive në Kosovë, e që janë 172,278, diku 0,11% e bizneseve të themeluara në vitet 2019 dhe 2020 kanë nënshkruar kontrata publike.


Kjo pra tregon se është një përqindje po ashtu e ulët e bizneseve që kanë lidhur kontrata të prokurimit. Kjo për faktin se bizneset e reja nuk kanë përvojë të mjaftueshme dhe nuk mund të sigurojnë cilësinë më të mirë të punës. Gjithashtu një arsye tjetër mund të qëndrojë, pasi që jo të gjitha bizneset mund të kenë fokus pune pjesëmarrjen në aktivitete të prokurimit.

## LLOJET E KONTRATAVE PUBLIKE

Gjatë vitit 2020 bizneset e reja të krijuara gjatë vitit 2019 dhe 2020 kishin lidhur gjithsej 196 kontrata, 34 prej të cilave ishin kontrata pune, 188 kontrata të furnizimit dhe 44 kontrata të shërbimeve.

Në dy grafikonet e mëposhtme në mënyrë grafike janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin dhe vlerën e kontratave për punë, furnizim dhe shërbime të nënshkruara nga bizneset e reja gjatë vitit 2020.

### Lloji i kontratave për vitin 2020




Grafikoni 8.

Numri i llojit të kontratave nga bizneset e reja dhe jo të reja të nënshkruara nga bizneset e reja gjatë vitit 2020

Vlera e kontratave të punës të lidhura gjatë këtij viti nga bizneset e reja ishte 778,853.83 euro, vlera e kontratave të furnizimeve ishte 1,448,076.60 euro, ndërkaq vlera e kontratave të shërbimeve ishte 343,469.72 euro. Njëjtë sikurse me llojin e kontratave, ka dallim të madh me vlerën e kontratave të lidhura me bizneset e reja në raport me bizneset jo të reja.


## Vlera e kontratave për vitin 2020 (€)



**Grafikoni 9.**

Vlera e kontratave nga bizneset e reja dhe jo të reja të nënshkruara nga bizneset e reja gjatë vitit 2020

Objekti i kontratave të punës të lidhura nga bizneset e reja gjatë kësaj periudhe, po ashtu, ka qenë në lidhje me çështje të ndryshme, duke përfshirë kontratat për ndërtimin dhe riparimin e rrugëve, ndërtimin e hapësirave të gjelbërta, ngritjen e punishteve, ndërtimi i urave, asfaltimin e rrugëve etj. Ndër bizneset që kanë lidhur kontrata të llojit punë është "VB INVEST SH.P.K.". Ky biznes një kontratë e ka lidhur me Komunën e Obiliqit në vlerë prej 156,823.84 euro për asfaltimin i disa rrugëve të kësaj komune. Data e nënshkrimit e kontratës është 21 gusht 2020, e që sipas statusit në e-prokurim është ende në përgatitje dhe kontrata si e tillë nuk ka datë të përfundimit. Kjo kompani ka nënshkruar edhe tri kontrata të punës me Komunën e Lipjanit. Njëra kontratë ka të bëjë me ndërtimin e rrugicave në fshatin Dobrajë, me vlerë 43,293.94 euro. Kontrata tjetër ka të bëjë me asfaltimin e rrugëve në Topliqan me vlerë 55,590.98 euro dhe e fundit është lidhur për asfaltimin e rrugëve në Shalë, me vlerë 49,839.25 euro. Po ashtu edhe statusi i këtyre tri kontratave sipas e-prokurimit është ende në përgatitje dhe nuk kanë datë të përfundimit. Duhet të theksohet se në dosjet e tenderit për këto aktivitete të prokurimit, është kërkuar përvojë në projekte të realizuara në tri vitet e fundit llogaritur nga data e publikimit të njoftimit për tender. Bazuar në Njoftimet mbi vendimin e autoritetit kontraktues për operatorin e suksesshëm, të gjitha këto kontrata janë fituar mbi kriterin e çmimit më të ulët.



**Figura 4.**

Pasqyrimi i VB INVEST SH.P.K nga butoni i rrjetëzimiti me institucionet që ka lidhur kontrata.

Në kudër të kontratave të llojit punë, gjatë vitit 2020, Komuna e Kaçanikut ka lidhur kontratë me "P&I SH.P.K." për renovimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj" në Kaçanik. Vlera e kësaj kontrate është 40,912.76 euro, ndërkaq sipas statusit në e-prokurim është në përgatitje. Kjo kontratë është fituar në bazë të kriterit të çmimit më të ulët. Duhet të theksohet se në e-prokurim në dosjen e tenderit mungon kontrata për këtë aktivitet të prokurimit.



**Figura 5.**

Pasqyrimi i P&I SH.P.K nga butoni i rrjetëzimiti me institucionet që ka lidhur kontrata.

Në muajin gusht të vitit 2020 Komuna e Dragashit nënshkruan kontratë me "LIMITPROJECT SH.P.K." për Adaptimin e hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF në Dragash. Vlera e kësaj kontrate është 74,487.19 euro, kurse statusi në e-prokurim për mbarëvajtjen e saj është në përgatitje. Po ashtu, edhe kjo kontratë është fituar në bazë të kriterit të çmimit më të ulët.

Në shumicën e aktiviteteve të prokurimit në kuadër të llojit "punë", në dosje të tenderit është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të kenë dëshmi për aktivitete të ngjashme në tre vitet e fundit. Më specifikisht, 16 prej këtyre kontratave ishin përmes procedurës së hapur, 10 përmes procedurës së kuotimit të çmimit dhe 8 përmes procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë të cilat ishin kryesisht punë shtesë.

Ndërkaq objekti i kontratave për furnizime të nënshkruara gjatë kësaj periudhe nga bizneset e reja ishte kryesisht për furnizime me dezinfektues për banorët në hyrje të ndërtesave, furnizimi me tunel dezinfektues, dhe maska ditore higjienike, pastaj furnizimi i bibliotekave me inventar, furnizimi me Klor Dioksid për dezinfektimin e ujit, me pajisje për shuarjen e zjarrit, furnizimi me tonerë, kompjuterë, pelet, pajisje sportive, goma, bateri për automjete dhe të ngjashme.


Në kuadër të llojit të kontratave "furnizim", biznesi "AWA SH.P.K", i themeluar me 28 gusht 2019, ka lidhur gjithsej 12 kontrata gjatë vitit 2020 me institucione publike të ndryshme. Këto kontrata kishin të bëjnë me "Furnizimin me tape (ultrium 6.25 TB RW data cartridge) sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së", "Furnizim me materiale për pastrim dhe materiale tjera për IAP", "Furnizim me mjete mbrojtëse në punë", "Furnizimi me tepih, perde, për institucionet e Komunës së Shtimes", "Furnizim me inventar për KMDK-ne", "Furnizim me Material Higjienik", "Furnizim me materiale mbrojtëse dhe Dezinfektuese për nevojat e MF, Thesarit të Kosovës dhe NJIF-K", "Furnizim me pajisje mbrojtëse personale", "Furnizimi me pajisje sportive", "Furnizim me maska mbrojtëse shumë-përdorimshe, dezinfektues me bazë alkooli dhe dorëza një-përdorimshe", si dhe "Furnizim me rrobalarës dhe rrobatharëse për QKMF-në".

Vlera totale e këtyre kontratave ishte mbi 50 mijë euro. Në këto 12 kontrata, në 5 prej tyre është kërkuar dëshmi mbi përvojën profesionale në tri vitet e fundit. Kryesisht të gjitha kontratat janë fituar në bazë të kriterit të çmimit më të ulët ashtu siç është potencuar në Njoftimet mbi vendimin e autoritetit kontraktues për operatorin e suksesshëm



**Figura 6.**  
Pasqyrimi i AWA SH.P.K për kontratat e lidhura dhe vlera e tyre.

“GETNO L.L.C.” ka lidhur gjithsej 9 kontrata të llojit furnizim me autoritete të ndryshme publike, ndërkaq vlera e këtyre kontratave ishte mbi 30 mijë euro. Ngjashëm sikurse “AWA SH.P.K.”, edhe “GETNO L.L.C”, i themeluar në korrik të vitit 2019, ka ofruar furnizime të ndryshme, duke filluar nga teknologjia deri tek materiale dhe pajisje të ndryshme kundër Covid-19. Në 2 nga 9 dosjet e tenderit, kërkohet dëshmi mbi kapacitetet teknike profesionale të ngjashme në tri vitet e fundit. Ndërkaq, ashtu edhe siç potencohet në Njoftimet për operatorin e suksesshëm, ky biznes ka fituar këto dy kontrata në bazë të çmimit më të ulët, në krahasim me ofertat e bizneseve tjera. Duhet të theksohet se njëri aktivitet i prokurimit ka të bëjë me furnizimi me maska dhe dezinfektues dhe tjetri me furnizim me material mbrojtës më rastin e shfaqjes së virusit COVID-19 në Skenderaj.



**Figura 6.**

Pasqyrimi i GETNO L.L.C për kontratat e lidhura dhe vlera e tyre.

Pra përcaktimi i këtij kriteri në dosjet e tenderit në këto dy raste është i panevojshëm, meqenëse rastet e para të shfaqjes së pandemisë COVID-19 kanë qenë në muajin mars të vitit 2020, dhe kërkimi i dëshmisë mbi kapacitetet teknike dhe profesionale ashtu lidhje me furnizimin me materiale mbrojtëse ndaj virusit Covid-19 ka qenë e pamundur të krijohet më herët.

Edhe objekti i kontratave për shërbime, ka qenë në lidhje me çështje të ndryshme, duke filluar nga dezinfektimi i hapësirave të brendshme në institucionet publike, shërbime të autolarjes së veturave zyrtare, mirëmbajtja dhe pastrimi i zonave rurale, mirëmbajtja e kamerave të sigurisë, transporti i nxënësve, trajtimi i qenëve endacak, vendosja e roletave në objektin e komunës etj.

“D D D SH.P.K.” ka lidhur kontratë me Komunën e Podujevës për dezinfektimin e hapësirave të brendshme në institucionet komunale përmes procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë. Vlera e kësaj kontrate ka qenë 149,909.09 euro.



## Dezinfektimi i hapësirave të brendëshme në Institucionet komunale

BLERËSI	KOMUNA E PODUJEVËS →
INDUSTRIA	Shërbime te ndryshme
DATA E DHËNIES	2020-10-07
FURNIZUES	D D D SH.P.K. →
ÇMIMI (EURO ME TVSH)	149,909 Euro

**Figura 6.**

Kartela e kontratës e lidhur mes D D D SH.P.K dhe Komunës së Podujevës.

Po ashtu, edhe “DARDANIAA SH.P.K.” përmes procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë ka lidhur kontratë me Komunën e Lipjanit për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror - pjesa lindore (Lot 2). Vlera e kësaj kontrate ishte 28,228.96 euro.

Ashtu siç është theksuar në analizën për kontratat e vitit 2019, në shumicën e dosjeve të tenderit në kontratat e llojit furnizim dhe shërbime nuk është kërkuar përvojë profesionale apo dëshmi tjera ndër vite edhe për kontratat e vitit 2020.


Pra siç u theksua edhe më lartë, në rastin e dy kontratave të lidhura me “GETNO L.L.C.”, ka qenë e paarsyeshme dëshmia mbi kriteret teknik dhe profesionale, pasi që aktivitetet e prokurimit kanë qenë përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, e cila është shfaqur në Kosovë në mars të viti të kaluar. Si rezultat, për të gjitha bizneset që kanë pasur për aktivitet furnizime dhe shërbime të ngjashme, përgjigja ndaj pandemisë ka qenë një aktivitet i ri.

## VLERA MESATARE E KONTRATAVE KRAHASUAR ME BIZNESET JO TË REJA

Gjithashtu edhe në kontratat e lidhura nga bizneset e reja në vitin 2020, vlera më e lartë e tyre ishte për kontratat e punës. Përkatësisht, vlera mesatare e kontratave të punës ishte 22,907.50 euro, vlera mesatare e kontratave të furnizimit ishte 12,271.80 euro, si dhe vlera mesatare e kontratave të shërbimeve 7,806.1 euro.

Vlera mesatare e kontratave të lidhura nga bizneset e reja është paraqitur në tabelën e mëposhtme

## Vlera mesatare për llojet e kontratave të lidhura nga bizneset e reja dhe jo te reja (€)



**Grafikoni 10.**

Vlera mesatare e kontratave të nënshkruara nga bizneset e reja dhe jo të reja gjatë vitit 2020.

Kontratat e punës kishin vlerën më të madhe mesatare edhe nga bizneset jo të reja, të nënshkruara gjatë vitit 2019. Përkatësisht, vlera mesatare e kontratave të punës ishte 106,740.3 euro, vlera mesatare e kontratave të furnizimit ishte 33,510.1 euro, si dhe vlera mesatare e kontratave të shërbimeve 41,456.6 euro.

Bazuar në shifrat e paraqitura më lartë, vërehet se mesatarja është më e lartë në kontratat e punës tek bizneset e vjetra në raport me ato të reja, e njëjta vlenë për kontratat furnizim dhe shërbime. Këto vlera janë të pritshme dhe të pranueshme. Ashtu siç është theksuar më lartë për aktivitetet e prokurimit të llojit punë përvoja profesionale dhe ekspertiza në ndër vite është një kriter mjaft i rëndësishëm e që duhet të merret parasysh karshi specifikave të paraqitura në dosje të tenderit. Po ashtu, njëjtë sikurse për kontratat e lidhura në vitin 2019, edhe për kontratat e lidhura në vitin 2020 të llojit furnizim dhe shërbime, vlera mesatare është më e madhe tek bizneset jo të reja në raport me ato të vjetra.


# KRITERET E KËRKUARA PËR LIDHJEN E KËTYRE KONTRATAVE

Në shumicën e kontratave të lidhura gjatë vitit 2020, përkatësisht në 74 kontrata, është kërkuar dëshmi mbi gjendjen ekonomike-financiare dhe mbi kapacitetet profesionale, në 117 prej këtyre kontratave nuk është kërkuar asnjë dëshmi mbi kritere të tilla, ndërsa për 5 sosh nuk ka pasur të dhëna.

Në 69 kontrata ku është kërkuar dëshmia mbi gjendjen ekonomike-financiare dhe kapacitetet profesionale, 29 e tyre kanë qenë kontrata të llojit “punë”, 27 prej tyre kanë qenë kontrata të llojit “furnizim” dhe 13 të llojit “shërbime”. Për kontratat e llojit “punë” është shumë e rëndësishme përcaktimi i kriterit mbi kapacitetet teknike dhe profesionale. Ndërkaq ky kriter për kontratat e llojit “furnizim” dhe “shërbime” mund të jetë i rëndësishëm, por jo patjetër i domosdoshëm.

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur të dhëna në lidhje me numrin e kontratave publike të lidhura gjatë vitit 2020 në të cilat është kërkuar dëshmi mbi gjendjen ekonomike-financiare dhe kapacitetet profesionale, numri i kontratave në të cilat që nuk janë kërkuar kritere të tilla, si dhe numri i kontratave për të cilat nuk janë gjetur të dhëna.

## Kriteret e kërkuara për lidhjen e kontratave gjatë vitit 2020



**Grafikoni 11.**

Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020 në të cilat kërkohet dëshmi mbi gjendjen ekonomike dhe kapacitetet profesionale, si dhe numri i kontratave në të cilat nuk janë kërkuar kritere të tilla.


Kontratat e punës kishin vlerën më të madhe mesatare edhe nga bizneset jo të reja, të nënshkruara gjatë vitit 2019. Përkatësisht, vlera mesatare e kontratave të punës ishte 106,740.3 euro, vlera mesatare e kontratave të furnizimit ishte 33,510.1 euro, si dhe vlera mesatare e kontratave të shërbimeve 41,456.6 euro.

Bazuar në shifrat e paraqitura më lartë, vërehet se mesatarja është më e lartë në kontratat e punës tek bizneset e vjetra në raport me ato të reja, e njëjta vlenë për kontratat furnizim dhe shërbime. Këto vlera janë të pritshme dhe të pranueshme. Ashtu siç është theksuar më lartë për aktivitetet e prokurimit të llojit punë përvoja profesionale dhe ekspertiza në ndër vite është një kriter mjaft i rëndësishëm e që duhet të merret parasysh karshi specifikave të paraqitura në dosje të tenderit. Po ashtu, njëjtë sikurse për kontratat e lidhura në vitin 2019, edhe për kontratat e lidhura në vitin 2020 të llojit furnizim dhe shërbime, vlera mesatare është më e madhe tek bizneset jo të reja në raport me ato të vjetra.

## PROCEDURAT E APLIKUARA NË LIDHJEN E KËTYRE KONTRATAVE

Në shumicën prej këtyre kontratave, përkatësisht 120 prej tyre, është aplikuar procedura e kuotimit të çmimit, në 50 kontrata është aplikuar procedura e hapur e prokurimit, si dhe në 31 kontrata është aplikuar procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës.

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur të dhëna në lidhje me llojet e procedurave të prokurimit në të cilat janë lidhura kontratat gjatë vitit 2020.



**Grafikoni 12.**

Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2020, të klasifikuara në bazë të procedurës së zbatuar të prokurimit.

Nga ky grafik mund të vërehet se numër mjaft i madh i kontratave të lidhura gjatë këtij viti janë përmes procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë. Diku 7 prej këtyre kontratave ishin punë shtesë, tjerat kryesisht kishin të bëjnë me furnizim dhe shërbime, të cilat ishin si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, dhe që janë kërkuar veprime urgjente.

Pavarësisht kësaj, pas muajit qershor të vitit 2020 nuk ka qenë e nevojshme të përdoret kjo procedurë, pasi që tregu vetëm kishte filluar të normalizohej karshi kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve. Ndërkaq pas muaji shtator ishin nënshkruar 5 kontrata përmes kësaj procedurë nga bizneset e reja.

## VENDIMET PËR ANKESA PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA NË VITIN 2020

Në kontratat e nënshkruara në vitin 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) kishte marrur 4 vendime për ankesat e parashtruara nga palët e pakënaqura.

Prej këtyre vendimeve të marrura nga OSHP, në një rast ishte aprovuar pjesërisht ankesa, në një rast është refuzuar në tërësi, në një rast është hudhur si e palejuar, dhe në një rast ishte hudhur si e pasafatshme.

Llojet e vendimeve për ankesa në kontratat e lidhura në vitin 2020:	Ankesat e aprovuara	Ankesat e refuzuara	Ankesat e aprovuara pjesërisht	Ankesat e hudhura si të palejuara	Ankesat e pas-afatshme
Numri i vendimeve:	0	1	1	1	1

**Tabela 1.**

Numri dhe lloji i ankesave të ushtruara pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit për kontratat e nënshkruara në vitin 2020

Tek ankesa e aprovuar pjesërisht, shkak i ngritjes së ankesës nga pala e pakënaqur ishte pretendimi se Autoriteti Kontraktues (Kuvendi i Komunës së Prishtinës në këtë rast) kishte bërë shkelje të Nenit 7 dhe 28 të LPP-së duke vendosur kërkesa dhe specifikime teknike që favorizojnë një prodhues të caktuar dhe se Autoriteti Kontraktues kishte angazhuar një operator ekonomik që ka marr pjesë në hartimin e specifikimeve teknike për këtë aktivitet të prokurimit dhe i njëjti është distributor ekskluziv i prodhuesit për të cilin janë përshtatur specifikimet teknike të specifikuara në dosjen e tenderit të publikuar nga AK.

Pra OSHP kishte vendosur që të aprovoj pjesërisht si të bazuar ankesën (pretendimin e parë) dhe ka obliguar autoritetin kontraktues në këtë rast, ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit.

Tek ankesa e refuzuar, shkak i ngritjes së ankesës nga pala e pakënaqur ishte pretendimi se Autoriteti Kontraktues (Ujësjiellësi Rajonal Prishtina) ka vepruar në kundërshtim me nenet 1,7,28, 59 dhe 60 të LPP-së, meqenëse sipas saj, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm administrativisht, pasi që nuk plotëson specifikimet teknike si në dosjen e tenderit, dhe se Autoriteti Kontraktues kishte bërë publikimin e njoftimit për dhënje të kontratës ende pa skaduar afati për ankesë në OSHP.

Ndërkaq OSHP kishte vendosur që të refuzoj si të pa bazuar ankesën, meqenëse eksperti shqyrtues nuk kishte gjetur shkelje nga këto pretendime.

Tek ankesa e hudhur si e pas-aftshme, Organi Shqyrtues i Prokurimit kishte konstatuar se pala ankuese kishte humbur afatin ligjor për parashtrimin e ankesës, sepse e njëjta ankesën e kishte bërë në ditën e 10-të, por në ora 16:35 (pra jashtë orarit zyrtarë).

Tek ankesa e palejuar, sipas Organit Shqyrtues të Prokurimit, pala e pakënaqur e kishte pasur afatin 5 ditor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim pranë AKK-së, pra pala ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 dhe 9 të LPP-së në lidhje me rregullat e paraqitjes së ankesës për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues dhe paraqitjes së ankesave pranë OSHP-së.

---

# REKOMANDIMET

Si përgjigje ndaj të gjeturave të dalura nga analiza jonë në këtë raport, ne rekomandojmë:

- Në dosjen e tenderit të publikuar të përfshihen të gjitha të dhënat në lidhje me aktivitetin e prokurimit, duke përfshirë edhe kontratën si elementi më i rëndësishëm i këtij aktiviteti. Kjo për shkak se, gjatë analizimit të dosjeve të tenderit në disa raste ka pasur mungesë të kontratave të lidhura dhe të informatave tjera të nevojshme.
- Për secilin aktivitet të prokurimit, duhet të publikohen Dosjet e Tenderit. Mos publikimi i këtyre dosjeve përben shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik. Ky rekomandime vie pasi që për shtatë aktivitete të prokurimit publik nuk ka pasur Dosje të Tenderit.
- Për të gjitha kontratat e punës dhe kontratat e shërbimeve duhet të parashihen kritere specifike në lidhje me përvojën profesionale të nevojshme, shkathtësitë dhe kapacitetet e duhura.
- Kriteret e përcaktuara në lidhjen e kontratave të parapara në dosjet e tenderit t'i përshtaten kryekëput llojit dhe natyrës së kontratave që pretendohet të lidhen. Kjo për faktin se gjatë analizimit të dosjeve të tenderit kemi hasur në kontrata ku kërkohej "dëshmi mbi kapacitetet teknike profesionale të ngjashme në tri vitet e fundit" për kontrata në lidhje me furnizimin me materiale mbrojtëse ndaj COVID-19.
- Në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) të publikohen të gjitha të dhënat në lidhje me shkaqet e ndërrimit të statutit të bizneseve dhe arsyet e shuarjes dhe rithemelimit të tyre, si dhe bizneset e reja dhe ato që kanë ndërruar status të paraqiten në lista të veçanta, meqenëse ashtu siç janë krijojnë konfuzion për ata që e hulumtojnë këtë fushë.

# BURIMET

---

1. Portali Prokurimi i Hapur dhe Transparent: [www.prokurimihapur.org](http://www.prokurimihapur.org)
2. Portal i Prokurimit Publik "E-prokurimi": [www.e-prokurimi.rks-gov.net](http://www.e-prokurimi.rks-gov.net)
3. Bizneset e Hapura: <http://biznesetehapura.com>
4. Agjencia Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ABRK): <https://arbk.rks-gov.net/>
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës
7. Udhëzimi Administrativ për Caktimin e Kërkesave, Kushteve dhe Procedurave për Krijimin e Numrit Unik Identifikues